



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.976/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtare ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit KS Sigkos me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.R., kundër të paditurit Komuna e Ferizajt, në rigjykim dhe rivendosje sipas aktvendimit Kom.SHk.II.nr. 632/22 të datës 10.10.2022 duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – taksë komunale, vlerë kontesti 500.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse R.R. dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur S.V., me datë 28.12.2023 mori:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit KS Sigkos me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET Aktvendimi nr. 03-432/01-0080018/19 datë 18.11.2019 i Komunës së Ferizajit dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM dhe RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A R S Y E T I M

Dhomat e shkallës së Dytë të kësaj gjykate me aktvendimit Kom.SHk.II.nr. 632/22 të datës 10.10.2022, e kanë aprovuar si të bazuar ankesën e këtij paditësit, e kanë prishë Aktgjykimin A. nr. 3139/2019 të datës 02.11.2021, dhe lëndën e kanë kthyer në rigjykim dhe rivendosje në dhomat e shkallës së parë.

Paditësi KS Sigkos me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Komuna e Ferizajit, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovohet padia në tërësi si e bazuar, dhe të anulohet aktvendimi 3-432/01-0080018/19 datë 18.11.2019 i Komunës së Ferizajt. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se: KS SIGKOS nuk ka ushtruar ankese ndaj aktvendimit të drejtorisë së financave në Ferizaj, nuk qëndron pasi që ankesa është ushtruar me dt.11.07.2019 nga zotëri S.SH. i cili me autorizimin e dt.09.07.2019 ka ushtruar ankese për KS SIGKOS ku si prove i dorëzoi sot ankesën e dt.11.07.2019 si dhe autorizimin për S.SH. të dt.09.07.2019. ndërsa e paditura në procedurë Administrative me aktvendimin me nr.03.nr0292 të dt.03.04.2019, për vitin 2019 e ka ngarkuar gabimisht dhe pa baze KS "SIGKOS" me takse komunale për ushtrimin e afarizmit në territorin e komunës në shumë prej 500€ për piken apo vendin e shitjes tek rruga "Tahir Sinani", 486Y. Në këtë pikë KS "SIGKOS" nuk e ushtron këtë veprimtari afariste dhe nuk ka filial të saj apo njësi të saj, por veprimtarin këtu e ushtron biznesi individual S.SH. me numër të biznesit 810056194, si biznes i pavarur. zotëri S.SH. është agjent i jashtëm i cili sipas kontratës për ndërmjetësim i shet produktet e kompanisë "SIGKOS" me provizion dhe është përgjegjës për të gjitha obligimet ligjore për afarizmin e biznesit të tij. KS SIGKOS e ka filialin apo njësinë e saj në rrugën "Rexhep Bislimi" 315D ku edhe ushtron veprimtarin e saj në Ferizaj, dhe për këtë me kohë ka paguar tarifën për veprimtari afariste. andaj mbi bazën e kësaj i propozoj gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësi si të bazuar dhe ta anuloj vendimin e drejtorisë për financa në Komunën e Ferizajt si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e kontestit në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: mbeten në tersi në përgjigjen në padi si dhe në theksimet në seancat e mëparshme duke i kundërshtuar pretendimet e palës paditëse si të pa bazuara, ngase vendimi i Drejtorisë së Financave të Komunës e Ferizajt ka bazueshmeri juridike sepse objekti për të cilën është zhvilluar veprimtari afariste e subjektit KS "SIGKOS" ka ekzistuar në atë objekt. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 03 nr.0103 i dt.14.03.2019, pagesa bankare e dt.10.09.2019, aktvendimi 03 nr.0282 i dt.03.04.2019, vërejtja e komunës së Ferizajt e dt.02.12.2019, formulari për kërkesë apo ankese e dt.11.07.2019, vendimi 03-432/01-0080018/2019 i dt.18.11.2019, certifikata e regjistrimit të biznesit e dt.13.09.2017 së bashku me informatat mbi biznesin, kontrata me nr.384/2017 e dt.29.12.2017, përgjigja në padi e dt.10.11.2020, rregullorja 01 nr.186 e dt.03.01.2019, rregullorja e të hyrave vetanake të komunës së Ferizajt e dt dhjetor 2018, autorizimi nga “SIGKOS” për S.SH. i dt.09.07.2019.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Komuna e Ferizajt në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, të ushtruar ndaj aktvendimit nr. 0282 të datës 03.04.2019 të Drejtorisë së financave, Sektorit të të Hyrave në Komunën e Ferizajt. E paditura ka vlerësuar se biznesi i Z. S.SH., me numër 70249109 është funksional, ushtron veprimtari në Komunën e Ferizajt andaj edhe është tatimuar konform rregullores komunale për taksa, Tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, edhe përkundër faktit se S.SH. ka biznes të regjistruar në ARBK-ë si biznes individual, BI, ka numër unik identifikues 810056194 dhe se nuk është degë apo përfaqësi e selisë së biznesit me numër 70249109 KS Sigkos SH.A. – Prishtinë.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadsisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Nga aktvendimi i kontestuar shihet se ai përmban të meta të tilla, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues

përmban të dhëna të pamjaftueshme sa i përket konstatimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike, lidhur me taksën komunale për ushtrimin e veprimtarisë brenda territorit të komunës së Ferizajit, respektivisht komunikimin e një obligimi të tillë subjektit përgjegjës.

Gjykata nga aktvendimit kontestues ka gjetur se Komuna e Ferizajit nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike ngase nuk ka vlerësuar drejtë të gjitha elementet sa i përket aplikimit të taksës komunale për ushtrim të veprimtarisë, ngase e njëjta duhet t'i referohet subjektit që ushtron veprimtari në territorin e Komunës së Ferizajit, subjekt ky që është i regjistruar në ARBK-ë si biznes Individual dhe që ka numër unik identifikues të vetin dhe jo subjektit KS Sigkos Sh.A. me seli në Prishtinë që bazuar në kontratën nr. 384/17 të datës 29.12.2017, zt, S.SH. si më lartë vepron vetëm si Agjent i Jashtëm për Ndërmjetësimin e Shitjes së Sigurimeve. Tutje e paditura duhet të sqaroj për Gjykatën edhe faktin nëse veprimtaria e këtu paditësit KS Sigkos Sh. A. është e shtrirë në territorin e Komunës së Ferizajit qoftë si degë, përfaqësi apo filial i selisë mëmë në Prishtinë, duke specifikuar rrugën përkatëse ku është kjo degë, filial apo përfaqësi, dhe numrin e lokalit, dhe nëse e njëjta përputhet me të dhënat nga Aktvendimi nr. 0282/03.04.2019, pra me adresën e biznesit sipas këtij aktvendimi e që është në rrugën, nr. 486-Y në Ferizaj.

E paditura nuk e ka bërë të qartë as faktin se pse ka komunikuar me zt. S.SH. përfshirë edhe komunikimin e aktvendimeve kontestuese dhe në anën tjetër ka përdorur të dhënat e subjektit KS Sigkos Sh.A me seli në Prishtinë për ta ngarkuar me taksë komunale për ushtrim të veprimtarisë, pra cila është lidhja e Zt. S.SH. me subjektin KS Sigkos Sh.A me seli në Prishtinë.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipër cekura, Gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Andaj Gjykata e udhëzon të paditurën që në bazë të autorizimeve ligjore që ka me rregulloren komunale për taksat, tarifatat, ngarkesat dhe gjambat komunale, të nxjerr aktvendim të bazuar në dispozita ligjore dhe sipas gjendjes së vërtetuar faktike duke marrë për bazë edhe të konstatimet dhe vlerësimet e Gjykatës si më lartë, si dhe

gjithashtu në ri-procedure e paditura të vlerësoj të gjitha elementet lidhur me përgjegjësinë e subjektit përkatës S.S. BI më numër unik identifikues 810056194, ndaras nga subjekti tjetër KS Sigkos Sh.A. më numër unik identifikues 70249109 në raport me taksën komunale për ushtrim të veprimtarisë brenda territorit të Komunës së Ferizajit, sepse vetëm mbi bazën e një konstatimi të drejtë të gjendjes faktike mund të vijë deri tek zbatimi i sakte i të drejtës materiale.

Tutje e paditura nuk e ka vlerësuar as kontratën e Agjentit të Jashtëm për Ndërmjetësimin e Shitjes së Sigurimeve nr. 384/17 të datës 29.12.2017, të këtu paditësit dhe subjektit S.SH. BI me NRB 810056194, e sipas të cilës kontratë objekt i saj është shitja e produkteve të sigurimit për të cilat kompania është licencuar nga BQK-ja, të cilat produkte do të ofrohen nga agjenti i jashtëm me autorizime nga KS Sigkos Sh.A. bazuar në Ligjin për Sigurimet nr. 05/L-045.

Në këtë drejtim Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Komunën e Ferizajit, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të nenit 43, par 1 dhe 2, e 46, par 1 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.976/2022 datë 28.12.2023

Zyrtare Ligjore

Amire JAHIRI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.